



## NJOHURI STATISTIKORE

*E konsideroj të mirëqënë faktin që statisticienët mund të shohin se si statistika përputhet me traditën filozofike të arteve të lira. Statistika është një metodë e përgjithshme intelektuale që aplikohet kudo që shfaqen të dhëna, variacione, shanse. Është një metodë fundamentale sepse të dhënat, variacioni dhe shansi janë të gjithë pranishëm në jetën moderne. Me idetë e saj thelbësore është një disiplinë shumë më e pavarur sesa, për shembull, një degë e matematikës”.*

*David S. Moore, Distinguished Professor,  
Department of Statistics, Purdue University*

Përgatiti: Ariana MISHA

Tirane, Nëntor 2005

*Ky manual u përgatit në kuadrin e projektit “Civic Participation in Monitoring MDGS and NSSED 2005-2007” financuar nga SNV and UNDP Albania.*

## PËRMBAJTJA

### KAPITULLI 1: Rëndësia e njohurive statistikore

- 1.1 . Çfarë kuptojmë me njohuri statistikore, pse na shërbejnë
- 1.2 . Statistikat në monitorimin dhe vlerësimin e politikave
- 1.3 . Baza dhe parimet e statistikës
- 1.4 . *Pyetje për njohuritë statistikore*

### KAPITULLI 2: Të dhënat sasiore dhe cilësore

- 2.1 . Çfarë janë të dhënat
- 2.2 . Hyrje në statistikë, koncepte bazë
- 2.3 . Statistika deskriptive
- 2.4 . Të dhënat sasiore dhe cilësore
- 2.5 . *Ushtrime për statistikat deskriptive dhe interpretimin e tyre*

### KAPITULLI 3: Metodologjia e mbledhjes së të dhënave

- 3.1 . Burimet kryesore të të dhënave
- 3.2 . Vrojtimet me zgjedhje
- 3.3 . Vrojtimet sasiore dhe cilësore ndryshimet midis tyre
- 3.4 . *Ushtrim për mbledhjen e të dhënave*

### KAPITULLI 4: Treguesit

- 4.1 . Çfarë janë treguesit
- 4.2 . Si të zgjedhim treguesit
- 4.3 . Shembuj të monitorimit të treguesve
- 4.3 . *Ushtrime për treguesit dhe interpretimin e tyre*

### KAPITULLI 5: Shpenzimet publike-treguesit, matja dhe ndjekja e tyre

- 5.1 . Matja e treguesve për hartimin e politikave
- 5.2 . Shpenzimet publike
- 5.3 . Ushtrim

### KAPITULLI 6: Kartat e Raportimit të Qytetareve

- 6.1 . Çfarë janë kartat e raportimit të qytetarëve
- 6.2 . Shembuj

## SESSION PËRMBLEDHËS

## ANEKS: Ushtrime

## OBJEKTIVI I MANUALIT:

Në fund të sesionit, pjesëmarrësit do të jenë të aftë:

- § të përkufizojnë statistikën, rëndësinë e njohjes së tyre, parimet bazë;
- § të kuptojnë të dhënat dhe rëndësinë e tyre në prodhimin dhe analizat statistikore ;
- § si të dallojnë të dhënat sasiore nga ato cilësore;
- § si të ndërtojnë dhe interpretojnë një tabelë, grafik, apo tregues;
- § si të përdorin treguesit për monitorim;
- § si të interpretojnë treguesit e shpenzimeve publike;
- § të njohin studimin që bazohet në kartën e qytetarëve dhe të kuptojnë rëndësinë e tij

Kohëzgjatja : 6 orë

Materialet :

- § prezantim në powerpoint
- § materiale të shkruara
- § fletë flipcarti dhe markera
- § ushtrimet

Procedurat:

Pas mbarimit të shpjegimit të çdo kapitulli do të ketë një kohë rreth 10 minuta për pyetje mbi kapitullin, gjëra të paqarta, mendime.

Pas çdo seance do të ketë ushtrime nga kapitujt e zhvilluar. Ushtrimet do të jenë të njëjta për të gjithë pjesëmarrësit, por puna do të jetë individuale dhe prezantimi sipas dëshirës.

Në fund të kapitujve, do të ketë një seancë të shkurtër përmbledhëse mbi temat e shpjeguara. Pjesëmarrësve do t'u shpërndahet një ushtrim me disa të dhëna të thjeshta, dhe ata duhet të shkruajnë komentet -rreth një faqe ose edhe më pak. Pjesëmarrësit do të ndahen në grupe me 4-5 veta për ta zhvilluar këtë ushtrim. Në fund, një përfaqësues i grupit paraqet ushtrimin në mënyrë sa më të përmbledhur.

Konsiderata të fundit

Mbyllja

## Rëndësia e njohurive dhe kulturës statistikore

### 1.1 Çfarë kuptojmë me njohuri statistikore, përse na sherbejnë

*Statistika, do të thotë të nxjerrësh konkluzione nga të dhënat.* Psh.: Janë botuar të dhëna për shkallën e varfërisë në vend. Si janë marrë këto të dhëna? Janë anketuar familje në të gjithë vendin lidhur me nivelin e tyre të jetesës. Pyetjet konsistojnë në marrjen e informacionit për konsumin dhe të ardhurat, punësimin dhe papunësinë, pajisjet aftagjate dhe dërgesat nga emigracioni, nivelin arsimor dhe braktisjen e shkollës. Këto të dhëna bënë të mundur llogaritjen e konsumit në vlerë dhe kalori për të gjithë popullsinë dhe sipas rajoneve kryesore të vendit. Më tej, u llogaritën disa linja ose pragje varfërie dhe u llogaritën tregues të varfërisë për zona të ndryshme të vendit, për grup-mosha dhe për femra e meshkuj, duke marrë kështu një panoramë të qartë të situatës së varfërisë në vend. Në këtë proces, kanë qënë statisticienët që kanë zgjedhur familjet për studim dhe kanë nxjerrë konkluzione mbi bazën e të dhënave.

*Baza e statistikës është teoria e probabilitetit, që bazohet në matematikë.* Kështu, duke supozuar që çdo numër në loto ka mundësinë e njëjtë për t'u tërhequr, mund të gjejmë se sa shanse kemi për të fituar në loto me numrat që kemi zgjedhur. Kështu zgjedhim një numër të çfarëdoshëm (nganjëherë njerëzit zgjedhin datën e lindjes, etj.) dhe përpikemi të përshtatim llogaritjet duke marrë parasysh faktin që numri një mund të jetë blerë më shumë se p.sh.: numri 97. Për të bërë këtë ne duhet të veprojmë se sa bileta nga secili numër janë blerë çdo javë dhe sa nga çdo kombinim i numrave.

*Statistika gjithashtu ka të bëjë me krahasimet.* Për shembull, shansi për të fituar një loto është më i madh se të goditemi nga një rrufe? Një ilaç kundër një sëmundje të caktuar p.sh. tuberkulozit, ka më pak efekte anësore se një tjetër, ndërkohë që efektet përmirësuese janë të njëjta? Ky i fundit është një rast për t'u vrojtuar, pra për të mbledhur të dhëna, dhe më tej për t'i analizuar ato. Të tilla eksperimente duhet të kryhen përpara daljes në treg të çdo ilaçi të ri (mbi të gjitha ilaçi është për të shëruar pacientët dhe jo për t'i vrarë ata), që përbën një nga arsyet e kostos së lartë të medikamenteve.

*Statistika nevojitet në të gjitha nivelet e jetës.* Një seminar i zhvilluar shtroi përpara zyrtarëve qeveritarë nevojën e edukimit statistikor. Kur mendohet të shpenzohet një shumë e caktuar për të luftuar varfërinë, në radhë të parë duhet menduar nëse programi për të cilin do të shpenzohet do ta ulë vërtet varfërinë, në të kundërtën paratë shkojnë dëm dhe varfëria mbetet e njëjtë. Si e gjejmë nëse ne e kemi arritur këtë synim? Për këtë duhet vendosur më parë se cili është çelësi që na tregon se ne e kemi arritur këtë synim ose jo. Me fjalë të tjera, na nevojitet të studijojmë numrin mesatar të njerëzve që fitojnë para? Apo të ardhurat mesatare për familje? Apo numrin e bizneseve të reja të hapura? Apo çfarë? Pasi të kemi vendosur se çfarë duhet të masim, ne do të na duhet të

gjejmë si ti marrim të dhënat mbi të cilat do të vlerësojmë situatën. Më pas ne duhet të vendosim se sa i madh duhet të jetë ndryshimi që ne të themi se e kemi arritur objektivin tonë. Ky proces qëndron në bazë të punës së një statisticioni.

*Njohuritë statistikore i nevojiten publikut të gjërë.* Njohuritë statistikore nevojiten për të kuptuar apo për të qënë në gjendje të gjykojmë nëse një njoftim, një reklamë është e arsyeshme apo jo. Përpara se të thoni, "gënjeshtër, gënjeshtër të mallkuara dhe statistika," mendoni rreth asaj që thonë njerëzit, vlerësoni informacionin, dhe vendosni nëse duhet apo jo – bëhuni statistikisht të ditur (Milo Schields, Augsburg College). Për një qytetar të thjeshtë, edukimi statistikor është i rëndësishëm në dy drejtime: 1) është një nevojë për të kuptuar jetën e përditshme, 2) një domosdoshmëri për të marrë vendime personale dhe një mjet për të ushtruar një kontroll demokratik mbi administratën publike. Nga ana tjetër globalizimi i ekonomisë dhe përparimet teknologjike kërkojnë nga punonjësit të kenë njohuri statistikore, aftësi për të lexuar statistika dhe të zotërojnë një arsyetim statistikor. Tregjet e punës ofrojnë mundësi të shumta për ata që zotërojnë logjikë statistikore.

Në administratën publike, edukimi statistikor është veçanërisht i nevojshëm për ata që mbajnë pozicione menaxherësh. Decentralizimi i vendimarrjes administrative dhe menaxhimi mbi bazën e rezultateve kërkojnë zhvillimin e planifikimit eficient dhe sisteme monitorimi që mbështeten nga sisteme të informacionit statistikor.

Sipas studiuesve dhe ekspertëve edukim statistikor nuk do të thotë njohje në thellësi të statistikës, gjë që mund ta bëjnë vetëm një numër i kufizuar ekspertësh. Megjithatë në këtë edukim, njohuritë mbi konceptet bazë të statistikës dhe probabilitetit janë të domosdoshme, të kuptuarit e përmbajtjes së informacionit është elementi më kryesor. Është e domosdoshme të kemi aftësinë për të njohur kufizimet e të dhënave statistikore dhe saktësinë me të cilën mund të vlerësohen rezultatet statistikore.

### 1.2 Statistikat në monitorimin dhe vlerësimin e politikave

Informacioni dhe statistikat janë një instrument i fuqishëm në krijimin e një kulture përgjegjshmërie në realizimin e zhvillimit njerëzor. Treguesit statistikorë mbi zhvillimin, matja e tyre në mënyrë të vazhdueshme, bëjnë të mundur monitorimin e strategjive dhe politikave të zhvillimit.

Një nga treguesit e Objektive të Zhvillimit të Mijëvjeçarit është dhe treguesi i shkallës së varfërisë. Objektivi i vendosur deri më 2015 është që ky tregues të përgjysmohet. Këtë angazhim e ka marrë edhe shteti shqiptar. Nëse ky objektivi do të arrihet apo jo, na duhet të masim këtë tregues në një vit bazë dhe të dimë vlerën e tij dhe më pas të vendosim përgjysmimin e tij deri më 2015.

Tabela 1: Treguesit e mijëvjeçarit dhe angazhimi për ulje

| Treguesit                                                                  | 2002   | 2006  | 2015  |
|----------------------------------------------------------------------------|--------|-------|-------|
| 1.1 - Përqindja e popullsisë nën linjen absolute të varferise              | 25.40% | 22.0% | 13.0% |
| 1.2 - Raporti i hendekut të varferise (incidenca x thellesine e varferise) | 5.7%   | 5.0%  | 3.0%  |
| 1.3 - Pjesa e kuintiles me të varfer në totalin e konsumit                 | 12.7%  | 11.5% | 6.3%  |

Si burim të dhënash u përdor vërtetimi i quajtur LSMS2002, një instrument i ndërtuar pikërisht për të matur varfërinë dhe pabarazinë dhe monitorimin e treguesve. Sipas këtyre të dhënave dhe duke ndjekur metodologji të rekomanduara për këtë qëllim, treguesi i shkallës së varfërisë ishte 25.4%. Ky tregues ka një metadatë përkatëse që e bën si të thuash të ligjshëm për të qënë një tregues i monitorueshëm. Mbi këtë bazë, në dokumentin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim Ekonomik dhe Social, u vendosën objektivat për ta ulur në 20% deri në vitin 2006, dhe në 13% në vitin 2015 (tabela 1). Statistika do të vazhdojë rolin e saj informues dhe monitorues në mënyrë të rregullt në këto vite për të matur nëse këto objektiva po arrihen apo jo, nëse politikat ekonomike dhe sociale, masat prioritare të ndërmarra kanë qënë të efektshme dhe kanë çuar vërtet në reduktimin e varfërisë dhe në çfarë mase e kanë reduktuar atë.

### 1.3 Bazat dhe parimet e statistikës

Statistikat janë një e mirë publike. Statistikat janë një instrument i pazëvendësueshëm i informacionit mbi çdo aspekt të jetës së një vendi. Nëpërmjet tyre ne informohemi mbi gjëndjen statike dhe dinamike të zhvillimeve sociale dhe ekonomike. Nëpërmjet treguesve, tabelave dhe grafikeve, analizave dhe komenteve statistikave na njohin me situatën ku ndodhemi, bëjnë të mundur nëpërmjet projeksioneve të njihemi në mënyrë të përafërt në të ardhmen e pritshme, na japin një bazë, mbi të cilën mund të ngrihen hipoteza, studime, apo politika zhvillimi.

Për ata që kanë përgjegjësi, statistikave publike janë një instrument i vlefshëm për të njohur një kontekst dhe përcaktuar politikat për ndërhyrje; për qytetarët është një instrument i vlefshëm për të

vlërësuar aksionet e atyre që bëjnë politikat. Prandaj statistikave publike favorizojnë rritjen demokratike dhe pjesëmarrjen e ndërgjegjshme në zgjedhjet e vendit.

Qëllimi i tyre është t'i shërbejnë vendimmarrësve, shkencëtarëve dhe publikut të gjërë, duke ofruar një panoramë të gjithanshme të jetës në vend. Ato mbështeten në principe siç janë: (në përputhje me çfarë themeloi UN në vitin 1994 dhe me Rregulloren e Këshillit të Bashkimit Europian n.322/97) principet e paanshmërisë, besueshmërisë, rilevancës, efektivitetit, fshehtësisë dhe transparencës. Respektimi i këtyre principeve garanton cilësinë e informacionit të prodhuar dhe të shpërndarë.

INSTAT është institucioni përgjegjës për të dhënat zyrtare. Ai prodhon statistika zyrtare sipas një mandati publik dhe institucional që sanksionohet në ligjin për statistikën. Këto statistika vijnë nga nevoja e gjërë për informacion.

Shërbimi statistikor në Shqipëri është institucionalizuar më 1940 dhe sistemi statistikor më 1945, i përfaqësuar nga një drejtori e atashuar në Këshillin e Ministrave dhe më vonë në Komisionin e Planit të Shtetit. Në prill 1993, me aprovimin në parlament të ligjit për statistikën, INSTAT u themelua si një organizëm i veçantë nën varësinë e Këshillit të Ministrave. Roli dhe përgjegjësitë e tij ndryshuan në përshtatje me evolucionin e vendit drejt demokracisë.

INSTAT drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Këshilli i Statistikës, që programojnë, drejtojnë dhe vlerësojnë aktivitetet. Instituti përbëhet nga departamente, si Departamenti Ekonomisë, i statistikave sociale, i metodologjisë dhe IT dhe marëdhënjeve me jashtë. INSTAT ka zyrat e tij në të gjitha rrethet e vendit.


## 2. ÇFARË JANË TË DHËNAT

“Puna me të dhënat është art dhe shkencë” David Moore

### 2.1 Hyrje në statistikë, koncepte bazë

Me termin “të dhëna” kuptojmë shifra, vlera të ndryshme, fakte të mbledhura mbi njerëz, sende, objekte, nëpërmjet vrojtimeve, matjeve, regjistrimeve. Të dhënat janë informacion i papërpunuar. Ato në vetvete nuk janë dije. Për të kaluar nga të dhënat në dije rruga është e tillë: nga të dhënat tek informacioni, nga informacioni tek faktet dhe në fund nga faktet tek dijet (Figura 1).

Figura 1



Të dhënat bëhen informacion, kur duhet marrë një vendim. Informacioni bëhet fakt, kur mbështetet nga të dhënat. Faktet bëhen dije, kur përdoren në përbushjen e suksesshme të një procesi vendimi. Figura 1 tregon procesin e të menduarit statistikor që bazohet në të dhëna për të ndërtuar modele statistikore, të cilat ti shërbejnë vendimarrjes.

Prandaj ne kemi nevojë për analizë statistikore të të dhënave. Statistika vjen nga nevoja për të vendosur dijet në një bazë evidentimi sistematik. Kjo kërkon njohjen e ligjeve të probabilitetit, matje të veçorive të të dhënave si dhe lidhjet që ekzistojnë.

*Statistika është një varg metodash që përdoren për të mbledhur, analizuar, prezantuar dhe interpretuar të dhënat.*

Analiza e të dhënave statistikore përbledh 4 etapa:

1. Përcaktimi i një problemi
2. Mbledhja e të dhënave
3. Analiza e të dhënave
4. Raportimi i rezultateve

Kur punojmë me të dhëna, ne ndeshemi në nocionin variabël. Një *Variabël* është karakteristikë e personave, objekteve ose ngjarjeve që ndryshojnë në vlerë nga njeri-tjetri. Moshë është një variabël, njerëzit ndryshojnë nga njeri-tjetri nga mosha. Kombësia është një tjetër variabël, njerëzit ndryshojnë nga njeri-tjetri nga kombësia. Të ardhurat gjithashtu janë një variabël, njerëzit ndryshojnë nga njeri-tjetri nga vlera e të ardhurave që marrin. Pra, variabli tregon karakteristika, që ndryshojnë ndërmjet njerëzve, sendeve apo objekteve. Çdo gjë që nuk ndryshon, është një *konstante*.

Variablat ndryshojnë nga fakti sesa të matshëm janë, pra sa informacion të matshëm sigurojnë ata. Variablat ndryshojnë gjithashtu nga tipi i shkallës së matjes. Kështu një variabël klasifikohet në këto shkallë matjeje: nominal (emëror), ordinal (numëror), interval, ose raport.

Variablat *emërorë* janë variabla në formë teksti, pa ndonjë renditje (cilësorë). P.sh. “gjinia” është një variabël emëror që ka dy attribute “mashkull” dhe “femër” me një renditje të barabartë. Si do të veprojmë për t’i analizuar këto të dhëna? Çdo variabli, për qëllime të analizës i vendosim kode të caktuara në mënyrë konvencionale, p.sh. është vendosur një renditje e tillë për të koduar variablin gjini: 1 për mashkull dhe 2 për femër. Në këtë mënyrë këtë variabël kemi kthyer në numër, pra në një variabël sasior dhe jemi në gjendje ta numurojmë dhe të përshkruajmë karakteristikat e tij.

Tabela 2

| Te dhëna bruto |          | Tabelë     |          |
|----------------|----------|------------|----------|
|                |          | →          |          |
|                | Gjinia   | Kodi       | Gjithsej |
| Teuta          | femër    | 2 Meshkuj  | 2        |
| Besnik         | mashkull | 1 Femra    | 3        |
| Iliri          | mashkull | 1 Gjithsej | 5        |
| Edlira         | femër    | 2          |          |
| Diana          | femër    | 2          |          |

Variablat *numerikë* (ordinalë) kanë vlera të renditura. Atributet e një variabli numerik janë të renditura, në rend rritës apo zbritës. P.sh. vrojtimit rreth mirëqënies renditen në 5 kategori: shumë mirë, mirë, pa ndryshime, keq dhe shumë keq. Statusi socio-ekonomik i familjeve është një rast tipi i variablave numërorë.

Tabela 3: Situata financiare e krahasuar me një vit më parë

| Urbane            |      |
|-------------------|------|
| Përmirësuar shumë | 0.6  |
| Përmirësuar disi  | 30.9 |
| Pa ndryshime      | 48.4 |
| Përkeqësuar disi  | 7.3  |
| Përkeqësuar shumë | 3    |
| Nuk e di          | 9.9  |

Një variabël interval përmban attribute, që janë të ndara në mënyrë të barabartë. Një variabël interval do të ishte p.sh. temperatura e matur me shkallën Celsius. Nga njëra shkallë në tjetrën temperatura ndryshon me një gradë. Këta variabla janë të renditur dhe lejojnë që të bëjmë krahasime, p.sh. të themi që temperatura sot është 15 gradë C, ose 2 gradë më shumë se dje (13 gradë).

Variablat *përpjestimore (ratio)* supozohen të kenë attribute, të cilët kanë intervale të barabarta dhe fillojnë nga një pikë 0. P.sh. moshë apo datëlindja janë një variabël përpjestimore që kanë një pikë 0 atë të lindjes. Kjo veçori e këtyre variablave krijon mundësinë që ne të bëjmë edhe krahasime. P.sh. nëse themi që moshë e një personi është 90 vjeç, ne mund të vazhdojmë më tej duke krijuar përpjestime duke thënë p.sh. se një person me moshë 90 vjeç është dy herë më i moshuar se një person me moshë 45 vjeç.

*Me Njësi të analizës* kuptojmë persona, ngjarje, sende që studiohen, për të cilat ne duam të themi diçka. Njësia e analizës përbën në fakt nivelin në të cilin kryhen analizat. Njësia më e ulët do të ishte individ, p.sh. pjestarët e një familjeje në një vërtim pranë familjes, nxënësit e një klase, mësuesit e një shkolle, një ndërmarrje prodhimi, një pikë furnizimi me shumicë, etj. Por nivelet mund të jenë edhe me të agreguara. P.sh. familje, një shkallë më e lartë agregimi, qyteti, rajoni, vendi. Ose nxënësi, klasa, shkolla, shkollat e qytetit, të rajonit, të vendit.

Variablat ndahen në variabla të varur dhe të pavarur.

*Variabla të varur* quhen ata variabla që kanë një rol pasues ose të influencuar nga variabla të pavarur, os më thjesht variabla pasojë.

*Variabla të pavarur* quhen ata variabla që kanë një rol paraprirës ose shkakësor në lidhje me variabla të varur, ose më thjesht variabla shkakësorë.

*Variablat e varur dhe të pavarur përdoren gjerësisht në analiza dhe studime kërkimore.* Në studime gjithmonë kërkohen të zbulohen pikërisht ligjësitë, rregullat, lidhjet ndërmjet variablave.

*Lidhja midis variablave.* Dy ose më shumë variabla janë të lidhur me njëri-tjetrin. Dy variabla konsiderohen të lidhur, kur në një varg vërtimesh vlerat e tyre në çdo rast i korespondojnë njëra-tjetrës. Për shembull, në një varg vërtimesh të një numri të caktuar individësh pesha është gjithmonë e lidhur me gjatësinë, sepse njerëzit shtatëllatë janë më të rëndë se njerëzit shtatëllatë. Një shembull që tregon një lidhje të një variabli të varur nga ai i pavarur është dhënë në tabelën 4 variabli “*punëdhënësi*” është i pavarur, ai është shkak që variabli “*paga mesatare mujore*” të ndryshojë në funksion të punëdhënësit.

Gjithashtu variablat i ndajmë në diskrete dhe të vazhduar.

*Variabla diskrete* klasifikojnë persona, objekte ose ngjarje sipas llojit apo cilësisë së attributeve të tyre. Variabla diskrete mund të konsiderohen: gjinia, raca, gjendja civile, etj.

*Variabla të vazhduar* janë variablat që teorikisht mund të marrin të gjitha vlerat numerike të mundshme në një interval të dhënë. Shembuj të variablave të vazhduar janë pesha, gjatësia, shpejtësia, të ardhurat, etj.

Folëm deri tani për variablat dhe tipet e tyre. Nga vetë fjala variabël, kemi të bëjmë me karakteristika që variojnë, ndryshojnë në varësi të disa karakteristikave, ngjarjeve të tjera. Si e përshkruajmë këtë

Tabela 4

| Paga mesatare e një punonjësi sipas punëdhënësit 2002 |                             | Variabli i pavarur |  |
|-------------------------------------------------------|-----------------------------|--------------------|--|
| Punëdhënësi                                           | Paga mesatare mujore në lek | Variabli i varur   |  |
|                                                       |                             |                    |  |
| Organizatë jo-qeveritare                              | 25685                       |                    |  |
| Shoqëri Private                                       | 21309                       |                    |  |
| Individ privat                                        | 19368                       |                    |  |
| Shteti                                                | 17242                       |                    |  |
| Ndërmarrje shtetërore                                 | 13903                       |                    |  |
| Mesatare vendi                                        | 18680                       |                    |  |

Burimi: LSMS2002

ndryshueshmëri të karakteristikave të variablave të ndryshëm në përpunimin dhe analizën e të dhënave. Llogaritja e frekuencave është një përpunim i thjeshtë i të dhënave. Çfarë quajmë frekuencë?

*Frekuenca është shprehja e ndeshjes së një karakteristike të caktuar në një varg të dhënash.*

Kur ne kryejmë një vërtetim, dhe duam të analizojmë rezultatet, në radhë të parë llogarisim frekuencat e variablave të ndryshëm për të cilët kemi mbledhur të dhëna.

Tabela 5: Frekuenca e var. "diploma më e lartë"


| Diploma më e lartë e marrë | Frekuenca | Përqindja | 2002                 |
|----------------------------|-----------|-----------|----------------------|
|                            |           |           | Përqindja progresive |
| Pa diplomë                 | 1434      | 11.1      | 11.1                 |
| Me 4 vjeçare               | 2525      | 19.5      | 30.6                 |
| Tetëvjeçare                | 5022      | 38.9      | 69.5                 |
| E mesme e përgjithshme     | 1660      | 12.8      | 82.3                 |
| Profesionale 2 - vjeçare   | 217       | 1.7       | 84.0                 |
| Profesionale 4 - vjeçare   | 1283      | 9.9       | 93.9                 |
| Universitare               | 743       | 5.7       | 99.7                 |
| Pasuniversitare            | 39        | 0.3       | 100.0                |
| Total                      | 12923     | 100.0     |                      |

Burimi:LSMS2002

Paraqitja grafike është një mënyrë tjetër për të paraqitur frekuencat. Histogramat janë forma më e përhapur dhe më e thjeshtë e paraqitjes së një frekuence.

Grafiku 1


Kategorite e të ardhurave



Në këtë grafik teorik (grafik 1), paraqitet histograma e një variabli të caktuar. Vija e zezë tregon shpërndarjen normale, si do të ishte shpërndarja perfekte, simetrike. Në fakt histograma tregon që shpërndarja është asimetrike.

Në shëmbullin e mëposhtëm jepet paraqitja grafike e tabelës së mësipërme të frekuencave të variablit "Diploma".


Grafiku 2



Një tjetër formë e paraqitjes grafike të të dhënave janë grafikët në formë byreku. Këto janë grafikë që paraqesin shpërndarjen e një variabli të vazhduar ose të kategorizuar. Në rastet kur variabli ka shumë kategori nuk është e vlefshme paraqitja në këtë formë. Në grafikun më poshtë jepet paraqitja në formë të tillë e variablit të ardhurat.

Grafiku 3

Shpërndarja e të ardhurave



Akoma më informuese bëhen tabelat e frekuencave, kur përveç frekuencave për çdo kategori ne japim edhe shumën progresive të tyre, për të kuptuar më mirë shpërndarjen.

Nga llogaritja e frekuencës progresive mund të derivojnë statistika të nevojshme që quhen percentilet.

Çfarë janë percentilet?

*Percentilet* janë fraksione që ndajnë një varg të renditur vlerash në pjesë të barabarta. Çdo vlerë e tyre përfaqëson një pjesë të caktuar të një shpërndarjeje vlerash të vendosura në rend rritës.

Percentilet janë një rast i veçantë i kuantileve. *Kuantilet* ndajnë një varg vlerash (vërtetimesh) në grupe në proporcione të njohura në secilin grup. Raste të kuantileve janë kuartilet, kuintilet dhe decilet.

Kuartilet janë grupe me nga 25%, pra janë vlera që ndajnë vargun në 4 pjesë të barabarta, ku çdo pjesë përfshin 25 të vërtetimeve.

Decilet janë grupe me nga 10%, pra janë vlera që ndajnë vargun në 10 pjesë të barabarta, ku çdo pjesë përfshin 10% të vërtetimeve.



Tabela 6: Shpërndarja e të ardhurave sipas grupeve pesëshe të popullsisë

| Kuintile të konsumit për frymë | Konsumi për frymë në përqindje |
|--------------------------------|--------------------------------|
| Kuintile e parë                | 12.4                           |
| Kuintile e dytë                | 16.0                           |
| Kuintile e tretë               | 19.6                           |
| Kuintile e katërt              | 21.8                           |
| Kuintile e pestë               | 30.2                           |
| Gjithsej                       | 100                            |

Burimi: LSMS2002

Në tabelën 6 pasqyrohet shpërndarja e popullsisë (familjeve) sipas klasave pesëshe të variablit të vazhduar "konsumi për frymë". Tabela na tregon se konsumi nga individët e kuintilës së parë, përbën 12.4% të konsumit total të popullsisë. Ndërsa konsumi i individëve të klasës së pestë, përbën 30.3% ose gati një të tretën e konsumit total të popullsisë. Pra, qëllimi i llogaritjes së frekuencës progresive, ndarja në 5 klasa të barabarta, me renditje nga më e ulta tek më e larta na lejon të krahasojmë dhe të arrijmë në përfundime.

## 2.2 Statistika deskriptive

Një *statistikë* është një numër i llogaritur nga një varg të dhënash. P.sh. paga mesatare prej 18,680 lekësh është një statistikë e llogaritur nga të dhënat e çdo individi të pyetur për pagën mujore në një vërtetim pranë familjeve.

Metodat e analizave statistikore na ndihmojnë të llogarisim dhe interpretojmë statistika që na duhen. Statistikat që na ndihmojnë të përshkruajmë një popullsi quhen *statistika deskriptive*. Shëmbuj të statistikave deskriptive janë *përqindjet, mesataret, moda, varianca dhe korelacionet*.

*Statistikat që vijnë si rezultat i përgjithësimit nga një zgjedhje probabilitare quhen statistikat e përgjithësimit*. Ato përdoren për të përshkruar një popullsi nëpërmjet studimit të karakteristikave të një kampioni të zgjedhur të popullsisë. Kështu këto statistika mund të jenë edhe deskriptive.

Çfarë janë *matjet e tendencës qendrore*? Matjet e tendencës qendrore përfshijnë: modën, medianën dhe mesataren.

*Moda* është vlera që haset më shpesh në një shpërndarje të frekuencave.

*Mediana* është një tjetër matje e tendencës qendrore. Mediana është vlera ndarëse e një shpërndarje vlerash të renditura nga më e ulta tek më e larta. Mediana e ndan këtë varg vlerash të renditura në dy gjysma të barabarta.

*Mesatarja* është shuma e të gjitha vlerave të vrojtuesve të një variabli të vazhduar, pjesuar me numrin total të vrojtuesve. Mesatarja është e thjeshtë dhe e ponderuar.

Në tabelën 7 kemi 12 raste të vrojtuesve për moshën dhe gjininë. Për të llogaritur moshën mesatare të këtyre personave zbatojmë formulën e mesatares së thjeshtë:

$$\bar{X} = \frac{\sum x_i}{n} \text{ për } i = 1 \dots n$$

Nëse në vargun e të dhënave një vlerë ndeshet më shumë se një herë, na duhet të llogarisim mesataren e ponderuar.

$$\bar{X} = \frac{\sum x_i f_i}{n} \text{ për } i = 1 \dots n$$

Në një shpërndarje pothuajse simetrike normale të një variabli të vazhduar, që mund të jetë e ardhura mujore, etj. moda, mediana dhe mesatarja bien shumë afër me njëra-tjetrën. Por në një shpërndarje asimetrike këto tri matje të tendencës qendrore ndryshojnë nga njëra-tjetra. Në një shpërndarje të çfarëdoshme, vlera e medianës është rreth 20% më e ulët se mesatarja.

Tabela 7

| Rasti | Emri   | Mosha | Gjinia |
|-------|--------|-------|--------|
| 1     | Agim   | 59    | M      |
| 2     | Yllka  | 57    | F      |
| 3     | Eni    | 29    | F      |
| 4     | Olsi   | 25    | M      |
| 5     | Pati   | 17    | F      |
| 6     | Hasan  | 78    | M      |
| 7     | Eva    | 70    | F      |
| 8     | Ilir   | 54    | M      |
| 9     | Elsa   | 49    | F      |
| 10    | Imir   | 29    | M      |
| 11    | Mimoza | 25    | F      |
| 12    | Altin  | 3     | M      |

Mesatarja dhe mediana ndryshojnë, sepse në mesatare ndikojnë vlerat ekstreme, që në rastin tonë janë minimumi prej 12,000 lekësh dhe maksimumi prej 90,000 lekësh. Ndërsa mediana nuk influencohet nga vlerat ekstreme, sepse është një vlerë në mesin e vargut që e ndan atë përgjysëm. Pra është një vlerë e mesme. Prandaj shpesh preferohet mediana në vend të mesatares.

Tabela 8

|           |          |
|-----------|----------|
| Mesatarja | 26,797.5 |
| Mediana   | 21,250.0 |
| Minimum   | 12,000.0 |
| Maximum   | 90,000.0 |
| Moda      | 26,000.0 |


*Variacioni*: Për matjen e variacionit të variablave diskrete dhe të vazhduar ka shumë mënyra. Disa prej tyre që ne vetëm do t'i përmendim janë: indeksi i ndryshueshmërisë (diversity index), indeksi i variacionit cilësor (index of qualitative variation), rang, dhe deviacioni mesatar, varianca dhe deviacioni standart.

Ç'është varianca, çfarë na tregon ajo:

Varianca është mesatarja e deviacioneve në katror të çdo vlerë ndaj mesatares, në një varg vlerash të vazhduara. Që do të thotë se varianca e një variabli  $Y$ , është deviacioni mesatar kuadratik. Varianca është gjithmonë një numur jo-negativ për shkak të ngritjes në katror.

Kurba në grafikun 4 është paraqitja më kuptimplotë e shpërndarjes. Statistika quhet ndryshe edhe *shkenca e shpërndarjes*. Shpërndarja normale ose siç quhet ndryshe kurba e Gausit, shpreh shpërndarjen probabilitare për variabla të vazhduar. Termi shpërndarje normale në fakt nuk përputhet me realitetin. Mund të jenë shumë të ralla të dhënat që të rezultojnë me një shpërndarje normale. Forma e çdo shpërndarjeje normale përcaktohet nga dy vlera: mesatarja e popullsisë dhe varianca


Grafiku 4



Deviacioni standart është rrënja katrore e variances.

Le të shohim shpërndarjen në grafikun e mëposhtëm: Në grafikun 5 japim shpërndarjen e familjeve sipas konsumit për frymë. Në kuptojmë se kurba e Gausit në këtë rast ka një shpërndarje me tendence negative që do të thotë se frekuencat më të shpeshta janë drejt vlerave minimale të konsumit. Teorikisht kjo shpërndarje duhet të ketë krahët të baraslarguar nga mesatarja (shih grafikun 5), por asnjherë ose shumë rallë kjo mund të ndodhë në jetën reale. Kur krahët e kurbës janë të ngushtë varianca është e vogël dhe e kundërta. Të dy bishtat e kurbës variojnë nga  $-\infty$  në  $+\infty$ , ato i afrohen boshtit horizontal por asnjherë nuk e prekin atë.

Grafiku 5



Tabelat e kryqëzuara:

Tabelat e kryqëzuara ndeshen shpesh dhe shprehin frekuencat e dy variablave diskretë që kanë  $r$  rreshta dhe  $k$  kolona. P.sh.: Të dhënat bruto jepen në tabelën 9: ku kryqëzohen dy variabla, të cilët kanë nga dy kategori, variabli "Gjinia" dhe "a keni ndjekur shkollën". Qelizat që përbëjnë trupin e çdo tabele tregojnë rezultatit e përbashkët të dy variablave. Totali në anën e djathtë tregon totalin e rreshtave dhe ato në fund të tabelës tregojnë totalin në kolona.

Tabela 9: A keni ndjekur shkollën?

|          | Gjinia  |       |          |
|----------|---------|-------|----------|
|          | Meshkuj | Femra | Gjithsej |
| Po       | 6,337   | 6,586 | 12,923   |
| Jo       | 341     | 629   | 970      |
| Gjithsej | 6,678   | 7,215 | 13,893   |

Totali në rreshta dhe në kolona që quhet ndryshe edhe shpërndarje marginale, tregon një shpërndarje frekuencash të dy variablave të kryqëzuar. Por shifrat absolute të pasqyruara në këtë tabelë, nuk tregojnë ndonjë lidhje të mundshme, të pritshme të dy variablave që po shqyrtojmë. Përqindjet në një tabelë të kryqëzuar llogariten brenda kategorisë së variablit të pavarur, në rastin tonë brenda kategorisë së gjinisë së popullsisë (tabela 8).

Në tabelën 10 tregohet se 94.8% e meshkujve kanë ndjekur shkollën krahasuar me 91.2% të femrave. Nëse variablat nuk do të ishin të lidhur atehere shpërndarja e popullsisë që ka ndjekur shkollën do të ishte e njëjtë për të dy gjinitë, dhe për pasojë edhe totali në rreshta do të ishte i njëjtë.

Tabela 10: A keni ndjekur shkollën?

|          | Gjinia  |       |          |
|----------|---------|-------|----------|
|          | Meshkuj | Femra | Gjithsej |
| Po       | 94.9    | 91.3  | 93.0     |
| Jo       | 5.1     | 8.7   | 7.0      |
| Gjithsej | 100.0   | 100.0 | 100.0    |

### Korelacioni:

Fenomenet e ndryshme janë të lidhur me njëri-tjetrin. Në analizën matematike studihet një lidhje e tillë që është varësia funksionale. Funksioni është ligji i vendosjes së korrespondencës ndërmjet madhësive, ku për çdo vlerën të njëres madhesi le ta quajmë  $x$ , i përgjigjet një vlerë e vetme plotësisht e përcaktuar e tjetres, që e quajmë  $y$ . Veç kesaj varësie, ka edhe varësi të tjera që japin lidhjet ndërmjet fenomeneve. Bëhet fjalë për varësi nën ndikimin e disa faktorëve njëkohësisht. Në këtë rast, për çdo vlerë të madhësisë  $x$  ka më shumë se një vlerë të madhësisë  $y$ . Në këtë rast kemi të bëjmë me varësi statistikore ose korelative.


**Korelacioni mat lidhjet midis dy ose më shumë variablave.** Lidhjet korelative klasifikohen sipas *formës*: drejtvizore ose e lakuar.

Lidhjet korelative klasifikohen sipas *drejtimit*: pozitive dhe negative. Klasifikohen sipas *numrit të madhësive* që studjohen: të thjeshta ose bashkësiore.

Koeficientët e korelacioneve variojnë nga -1.00 to +1.00. Vlera -1.00 në fakt përfaqëson një korelacion perfekt negativ, ndërsa vlera +1.00 përfaqëson një korelacion perfekt pozitiv. Vlera 0.00 tregon që nuk ka korelacion. Vlerat e vërteta që tregojnë shkallën e lidhjes ndërmjet variablave ndodhen midis -1 dhe +1.

Korelacioni drejtvizor (Linear) quhet korelacioni Pearson (Pearson  $r$ ). Korelacioni linear shpreh lidhjen midis dy variablave në formë intervali-raporti dhe përcakton masën në të cilën vlerat e dy variablave janë të lidhur me njëri-tjetrin. Sa më afër njëshit të shkojnë vlerat e koeficientit të korelacioneve, aq më lineare bëhet lidhja midis dy variablave, e cila tregon që për çdo vlerë të variablës  $x$  i përgjigjet një vlerë e variablës  $y$ . Në fakt lidhja lineare do të ishte lidhja perfekte, ose  $r=1$ . Lidhja midis variablave përmbledhet në një vijë që quhet vija ose linja e regresionit dhe përfaqëson shumën në katror të distancave të vlerave nga kjo linjë. Në figurë (grafik 6) jepen 4 shembuj, kur  $r=0$ ,  $r=30\%$ ,  $r=60\%$  dhe  $r=90\%$ . Për  $r=0$ , vija tregon një mungesë të plotë lidhjeje. Ajo është horizontale, ndërsa për  $r=90\%$ , vlerat janë shumë afër njëra-tjetres dhe linjës së regresionit, duke treguar një lidhje proporcionale.

Grafiku 6



### 2. 3 Të dhëna cilesore –analiza sasiore?

Folëm për të dhënat sasiore, atributet, vetitë, mënyrat bazë të analizës dhe manipulimit. Pamë se të dhënat mund të jenë në formë teksti, pra nominale, në formë numerike, intervali dhe raporti. Në rastin kur ato janë në formë nominale, është vështirë t'i nënshtrohen analizës. Atëherë ne pamë se duke iu venë përbri kode qoftë të renditura apo të parenditura, ato kthehen në të dhëna numerike dhe mund të konsiderohen sasiore dhe të manipulohen njësoj si variablat numerike. Dallimi midis tyre është se këto do të jenë variabla kategorike me dy apo më shumë kategori, por për to njësoj aplikohen frekuencat, përqindjet, tabelat e thjeshta dhe të kryqëzuara, grafikët, etj. Njësoj mund të studiohet korelacioni midis dy apo më shumë variablave si dhe të ndërtohen modele të ndryshme duke përdorur ekuacionet e regresionit. Format e përpunimit në këtë rast kanë faza të ndërmjetme siç janë pra kodimet, të cilat kanë rëndësinë e tyre dhe bëhen sipas një metodike të caktuar.

E njëjta logjikë funksionon për pyetsorë apo vrojtime cilësore. Këto janë instrumenta të dhënash që kombinojnë pyetje të strukturuar dhe gjysmë të strukturuar. Për t'i kthyer në sasiore dhe nënshtruar më pas analizës, përdoren lista kodesh, të cilat bëjnë të mundur përpunimin e mëtejshëm.

Në kërkimet shkencore cilësore tentohet të arrihet në gjetje të caktuara lidhur me hipoteza të ngritura që më parë. Në këtë kuptim, studiuesit që merren me kërkime cilësore (Guba and Lincoln) përcaktojnë 4 kritere për të gjykuar një studim cilësor. Nëse kemi parasysh në fillim të këtij dokumenti kemi përmendur veçoritë e statistikave publike. Kerkuesit dallojnë 4 kritere që sipas tyre dallojnë analizat sasiore dhe cilesore (shih tabelën 11)

Tabela 11

| Kriteret tradicionale për të gjykuar një studim sasiore                           |
|-----------------------------------------------------------------------------------|
| Vlershmëria e brendshme<br>Vlershmëria e jashtme<br>Besueshmëria<br>Objektiviteti |
| Kritere alternative për të gjykuar një studim sasiore                             |
| Besueshmëria<br>Transferueshmëria<br>Siguria<br>Vertetësia                        |

Studimet sasiore bëjnë mbledhjen dhe "transformimin" e informacionit në të dhëna statistikore. Teknikat që përdoren janë: monitorimi i shikuesve të një kanali të caktuar TV, intervistat me pyetsor, telefon, postë, etj. Vrojtmet pranë familjeve janë sasiore. Informacioni i mbledhur prej tyre përpunohet statistikiisht, monitorohen treguesit dhe nxirren konkluzione.

Studimet cilësore kërkojnë informacion më në thellësi dhe numri i pjesëmarrësve zakonisht është i vogël. Ky tip vërtetimi nuk është “i matshëm”. Kërkuesit kërkojnë të dhëna cilësore për të formuar opinione dhe jo për të përkufizuar një treg apo një grup të caktuar. Metodatat kërkimore më të zakonshme janë intervistat individuale dhe grupet e fokusit. Vërtetimet ose kërkimet për vlerësimin e nevojave janë cilësore, ato mbledhin opinione nga pjesëmarrësit në vërtetim.

### 3. Metodologjia e mbledhjes të të dhënave

#### 3.1 Burimet kryesore të të dhënave

Informacioni statistikor është një mjet i fuqishëm për të prezantuar çështje komplekse në një formë të gjithanshme, duke lejuar krahasimet midis rajoneve dhe periudhave kohore. Një shifër apo një tregues statistikor mund të shprehë situata dhe zhvillime në mënyrë të shpejtë dhe të përmbledhur përtej kufijve politikë dhe gjuhësorë.

Siç kemi përmendur më sipër mbledhja e të dhënave është hapi i dytë në një proces të analizës statistikore të të dhënave. Hapi i parë është ai i identifikimit të një problemi. Pa pasur të qartë se cili është problemi, përse duhet t'i nënshtrohet një studimi, nuk mund të punohet për mbledhjen e të dhënave. Pamë se si të dhënat kthehen në informacion, pastaj në fakte, dhe në fund në dije. Dijet janë një hallkë shumë e rëndësishme në procesin e vendimmarrjes.

Kërkesa për të dhëna të sakta për matjen e varfërisë dhe sisteme monitorimi ka ardhur në rritje për shkak të theksit gjithnjë e më të madh në menaxhimin mbi bazën e rezultateve. Dokumenti i Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit Ekonomik dhe Social dhe Objektivat e Mijëvjeçarit përmbajnë angazhime strategjike të qeverisë për uljen e varfërisë dhe rritjen ekonomike. Monitorimi i tyre ka të bëjë me faktin nëse objektivat e vëna dhe angazhimet e marra janë duke u arritur. Për të matur varfërinë, për të monitoruar programet dhe politikatat e qeverisë, nëse ato janë në përputhje me angazhimet e marra, janë të nevojshme të dhëna që bëjnë të mundur matjen e varfërisë, monitorimin, analiza të politikave, përcaktimi i shkaqeve, kush janë grupet e targetuara, vlerësimin e impaktit dhe simulimin e ndryshimeve.

#### Burimet e të dhënave

*Burimet kryesore të të dhënave që nevojiten për monitorimin dhe vlerësimin janë:*

Llogaritë Kombëtare  
Statistikat e Shpenzimeve Publike  
Çmimet  
Burimet Administrative  
Vlerësime të varfërisë me anë të pjesëmarrjes  
Vërtetime:

Vërtetime shumëqëllimëshe (LSMS/IS)  
Anketat e Buxhetit të Familjes  
Anketa e të Ardhurave dhe Shpenzimeve

Anketat e Forcave të Punës  
Anketat mbi Demografinë dhe Shendetin  
Anketa e shumë indikatorëve (MICS)  
Anketa e Përdorimit të Kohës

Burimet e mësipërme përbëjnë burimet bazë mbi të cilat ngrihen analiza, kërkime, ndërtohen hipoteza dhe arrihen përfundime që ishërbejnë politikëbërësve apo vendimmarrësve në nivele të ndryshme.

#### 3.2 Çfarë janë të dhënat administrative:

Të dhënat administrative përfshijnë regjistra, sic janë regjistrat e popullsisë apo të familjeve. Këtu do të klasifikonim regjistrat e gjëndjes civile. Burime të tjera të dhënash administrative janë ato që mbledhen në mënyrë periodike nga Ministrinë përkatëse, si Ministria e Arsimit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punës, Instituti i Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore, etj. Regjistra të tjera që shërbejnë si bazë të dhënash janë gjithashtu regjistrat e KESH, apo ato të pronave të paluajtshme. Të dhëna që vijnë nga bashkitë, komunat, drejtoritë arsimore, etj., të cilat nëse janë të rregullta, gjithëpërfshirëse, periodike, janë një burim shumë i mirë në sigurimin e informacionit edhe në njësi më të vogla administrative. Mbi bazën e të dhënave që vijnë nga sistemi i Ministrisë së Arsimit ndërtohen seri kohore për një sërë treguesish të arsimit si frekuentimi i shkollave, tregues të regjistrimit neto dhe bruto në nivele të ndryshme të arsimit, numri i nxënësve në shkolla, treguesi i numrit të nxënësve për mësues, etj.

Nga të dhënat që vijnë nga sistemi i Ministrisë së Shëndetësisë përfshirë edhe Institutin e Shëndetit Publik, ndërtohen tregues, si treguesit e vdekshmërisë (Objektivat e Mijëvjeçarit 4, 5 dhe 6), të vaksinimit dhe tregues të tjerë, si numri i të shtruarve për shtrat, numri i mjekëve për pacientë ose për banorë, etj.

Tregues socialë si numri i familjeve me ndihmë ekonomike, mund të ndërtohen nga të dhënat burim të sistemit të Ministrisë së Punës dhe Drejtorisë së Shërbimeve Sociale. Regjistrat e Zyrave të Punës janë burim për të matur papunësinë e regjistruar.

#### Anët pozitive të burimeve administrative:

Burimet administrative janë periodike, janë gjithëpërfshirëse, dhe krijojnë mundësinë e bërjes së analizave deri në njësi administrative më të vogla. Ato bëjnë të mundur ndërtimin e serive kohore dhe studimin e fenomeneve në dinamikën e tyre. P.sh. të dhënat nga drejtoritë arsimore me të cilat mund të ndërtohen shumë tregues të arsimit e kanë këtë mundësi.

#### Anët negative të burimeve administrative:

Është kusht i domosdoshëm i lidhur me saktësinë e të dhënave statistikore, që burimet administrative të jenë të plota dhe gjithëpërfshirëse. Në të kundërt, humbasin përfaqësueshmërinë dhe për rrjedhojë edhe saktësinë dhe besueshmërinë. Nga ana tjetër, mungon lidhja midis tyre si dhe fenomeneve të tjera si p.sh. varfëria, lidhje e domosdoshme për të kuptuar shkakun dhe pasojën.

### 3.3 Vrojtimit me zgjedhje

*Ç fare janë vrojtimit me zgjedhje:*

*Vrojtimit me zgjedhje janë metoda studimi që konsistojnë në studimin e një pjese të popullsisë të zgjedhur me teknika të caktuara, dhe në përgjithësimin e karakteristikave të kësaj pjese të popullsisë së studiuar, për të gjithë popullsinë.*

Vrojtimit ndahen në dy grupe të mëdha mbi bazën e universit që studiojnë: popullsia ose familjet, dhe ndërmarrjet.

Për të bërë të mundur zgjedhjen e një popullsie të caktuar nga një univers i caktuar, qoftë ky individ, familje, njësi ekonomike private apo shtetërore, etj., na nevojitet një listë e plotë e këtij universi. Për të studiuar individë, familje na duhet të kemi një listë të plotë të popullsisë ose familjeve, me të dhënat bazë përkatëse, si emri i kryefamiljarit, adresa, numri i telefonit, etj. Për të studiuar ndërmarrjet na nevojitet një listë të plotë të ndërmarrjeve aktive, adresat, aktivitetin e tyre kryesor, e të dhëna të tjera bazë si adresa, numri i telefonit, etj.

Ekzistenca e një liste të tillë është baza e fillimit të punës. Mbi këtë bazë, teknikienët hedhin shortin dhe zgjedhin njësitë statistikore (që mund të jenë familje apo ndërmarrje) për studim me tematika të caktuara. Ka shumë metoda të zgjedhjes, nga të cilat ajo që përdoret më shumë është metoda e zgjedhjes së rastit. Zgjedhja mund të jetë me disa shkallë ose me një shkallë. Ç'do të thotë kjo: nëse ne disponojmë një listë të plotë familjesh në rang vendi, sipas qarqeve, rretheve, qyteteve dhe fshatrave atëherë kjo na ndihmon që ne të bejmë një zgjedhje me shkallë, pra të zgjedhim në fillim zonat dhe më pas të zgjedhim për çdo zonë një numër të caktuar familjesh sipas madhësisë së zonës. Por si zgjedhja e zonave ashtu edhe e familjeve bëhen në mënyrë të rastit duke i dhënë të gjitha zonave dhe familjeve brënda zonave një probabilitet të njëjtë për t'u zgjedhur.

Raporti i numrit të familjeve për çdo zonë me totalin e popullsisë së zonës, na jep një koeficient që në fakt quhet koeficienti i zgjedhjes. Ky përdoret më pas për ekstrapolim të të dhënave të këtyre familjeve për të gjithë zonën, me korektimet përkatëse.

Madhësia e kampionit të zgjedhur për një vrojtimit të caktuar ndryshon në përmasa dhe varet nga tipi i vrojtimit, shkalla e detajimit të informacionit, etj. Nëse duhet të studiojmë tregun e punës, duhet të kemi një kampion shumë të madh familjesh, në mënyrë që përfaqësimi i tyre në kampion të jetë në masën e duhur dhe karakteristikat e tyre të dalin në pah dhe të studjohen. Madhësia e kampionit nuk varet nga madhësia e një vendi, por nga variablat që studiojmë, karakteristikat dhe shkalla e detajimit të tyre. Kampioni do të ishte i njëjtë si në nivel vendi ashtu edhe në nivel qarku në rastin e një vrojtimit të standarteve të jetesës. Nëse për një tip të tillë vrojtimit na duhet një kampion prej 3000 familjesh, po aq do të na duhej sikur këtë vrojtimit ta kryenim vetëm në Shkoder, Gjirokastrë apo Sarandë.

Prandaj edhe vrojtimit me zgjedhje kryhen në nivel vendi dhe arrijnë të detajojnë informacionin deri në nivel të parë: qytet-fshat. Në varesi nga madhësia e kampionit mund të bëhet detajimi edhe në nivel qarku, por me një shkallë më të ulët saktësie (ligji i numrave të mëdhenj). Kjo për arsye se kryerja e vrojtimit të tilla në nivel qarku është shumë e kushtueshme si përsa i përket burimeve njerëzore që angazhon ashtu edhe materialeve, kohës së harxhuar në mbledhjen, pastrimin, përpunimin e të dhënave.

*Anët pozitive të vrojtimit me zgjedhje:*

Japin një informacion të gjithanshëm për situatën social-ekonomike të familjeve, nga i cili mund të gjenerohen tregues dhe përfundime mbi situatën mikro dhe makro të vendit dhe të ndërtohen politikë përkatëse. Duke qënë një burim i integruar të dhënash, mund të studjohen lidhjet që ekzistojnë midis fenomeneve të ndryshme social-ekonomike, si psh varfëria dhe arsimi, varfëria dhe shëndeti, varfëria dhe të ardhurat, etj. dhe krijon mundësinë e monitorimit të impaktit të politikave sociale.

*Mangësitë e vrojtimit me zgjedhje:*

Vrojtimit me zgjedhje bazohen në një numër të kufizuar familjesh të zgjedhura përfaqësuese të popullsisë (shih më lart). Ndërtimi i treguesve deri në nivele të ulta varet në një shkallë të madhe nga madhësia e kampionit të lëshuar për studim. Disagregimi i të dhënave deri në zona të vogla ul ndjeshëm besueshmërinë dhe saktësinë e të dhënave duke i bërë ato të papërdorshme për qëllime të monitorimit dhe vlerësimit të politikave, programeve e projekteve.

### 3.4 Regjistrimet

Rregjistrimet e Popullsisë janë instrumenta për mbledhjen e të dhënave që sigurojnë një shtrirje rajonale deri në njësi shumë të vogla sic janë komunat/bashkitë. Duke qënë të tilla, janë shumë të kushtueshme dhe kryhen në periudha 5-10 vjeçare. Kjo i bën instrumenta të pavlefshëm pasi kalojnë disa vjet nga kryerja e tyre (kjo varet nga shpejtësia e zhvillimit të fenomeneve demografike në një vend të caktuar). Nga ana tjetër, rregjistrimet mbledhin një numur shumë të kufizuar të dhënash në lidhje me popullsinë dhe familjen dhe nuk hyjnë në detaje.

4. Çfarë janë treguesit, zgjedhja e treguesve të përshtatshëm për monitorimin dhe vlerësimin e projekteve, programeve, politikave dhe për të matur zhvillimin.

#### 4.1 Çfarë janë treguesit

*Treguesi është një variabel i thjeshtë ose një variabel i ndërtuar duke përdorur kombinimin e dy ose më shumë variablave.*

Treguesit janë ekonomikë dhe socialë. Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB-GDP) është një tregues ekonomik. Ai na tregon zhvillimin ekonomik të një vendi.

Treguesit ekonomike dhe sociale nuk kanë kufij të prerë, sepse shumë zhvillime në sferën ekonomike e kanë bazën në sferën sociale. Treguesit e varfërisë dhe pabarazisë janë tregues socialë, por janë të lidhur me zhvillimin ekonomik. Nga ana tjetër, zhvillimet ekonomike ndikojnë në zhvillimet sociale. P.sh. një shkurtim i shpenzimeve të buxhetit për përkrahjen sociale do të ketë pasoja sociale, të varfërit do të bëhen më të varfer. Kjo është shumë e rëndësishme për të kuptuar zhvillimin si një zhvillim socio-ekonomik.

*Treguesit janë të thjeshtë dhe të përbërë.*

Tregues të thjeshtë janë ata që përfaqësohen nga një variabël bazë, p.sh. numri i popullsisë është një tregues i thjeshtë: popullsia e Shqipërisë në vitin 2001 ishte 3,067,000 banorë, ky është një tregues i thjeshtë, që buron nga numërimi i popullsisë.

Treguesit e përbërë janë tregues që ndërtohen duke kombinuar dy ose më shumë variabla. P.sh. numri i banoreve për 1 km<sup>2</sup> është një tregues i përbërë që vjen nga dy variabla: numri i banoreve gjithsej dhe madhesia e sipërfaqes së vendit në km<sup>2</sup>. Treguesi i vdekshmërisë foshnjore është një tregues i llogaritur duke marrë për bazë numrin e vdekjeve për fëmijet e moshës nga 0 në 1 vjeç dhe numrin e fëmijve gjithsej të lindur brenda së njëjtës periudhe.

*Indekset janë një kombinim treguesish.* Ndërtimi i indekseve në fushën sociale ka ardhur si rezultat i synimit për të pasur tregues sintetikë të matjes së nivelit të jetesës dhe zhvillimit të një vendi. Një nga këta indekse është Indeksi i Zhvillimit Njerëzor, i cili është një bashkim i tre indekseve: PBB reale për frymë, jetëgjatësisë dhe Nivelit të shkollimit.

Treguesit ndahen : në tregues hyres (input). P.sh. kostoja e ndërtimit të një shkolle, është një tregues hyres ; tregues përfundim (output). P.sh. numri i shkollave të ndërtuara është një tregues përfundim.

Numri i nxënësve/studentëve të regjistruar, numri i të kënaqurve nga shkollat janë tregues të outcome ose rezultatit, ose tregues të performancës. Ndërsa treguesi i nivelit të shkollimit, që maten me testet që zhvillohen në shkolla është tregues i ndikimit (impact) që programi ka patur në një komunitet të caktuar (target) në rastin tonë tek nxënësit e shkollave. Raporti midis përfundimit dhe rezultatit quhet *efektivitet*.

Raporti i hyrës-përfundim ndaj treguesve të rezultatit-ndikimit është një tregues i *eficiencës* në realizimin e një programi, në shembullin tonë të programeve lidhur me arsimimin.

Treguesit janë të nivelit të ulët dhe të nivelit të lartë. Treguesit e nivelit të ulët ose tregues të inputit janë tregues që ndikojnë në arritjen e objektivave dhe synimeve, të cilët maten me tregues të nivelit të lartë që janë treguesit e rezultateve dhe ndikimit.

## 4.2 Si të zgjedhim treguesit

Treguesit që duhet të zgjidhen për të bërë monitorimin e politikave dhe programeve e projekteve duhet të jenë të përshtatshëm për një rol të tillë. Ata duhet të jenë *specifikë, të matshëm, të saktë, realistë dhe me afatë*.

### Specifike

Treguesi duhet të masë përfundimin, rezultatën ose ndikimin dhe jo elemente të tjera. P.sh. nëse objektivi i një programi arsimimi është të ndërtojë 5 shkolla në qarkun x, atëherë treguesi specifik që duhet të matet është numri i shkollave të ndërtuara. Ka edhe shumë tregues të tjerë, si p.sh. koha e shpenzuar për ndërtimin e shkollave ka lidhje, por nuk është specifikë për objektivin e vënë.

Nëse një target do të ishte reduktimi i kequshqyerjes akute të fëmijve nën 5 vjeç, atëherë treguesi specifik do të ishte përqindja e fëmijve nën 5 vjeç që janë shumë të kequshqyer (- 2 deviacione standart të peshës ndaj gjatësisë). Numri i vakteve të ushqimit të konsumuar nga fëmijet nën 5 vjeç është një tregues që lidhet me kequshqyerjen, por nuk është specifik.

### Të matshëm

Një tregues i përshtatshëm është i matshëm, variablat që merren për bazë duhet të jenë të përcaktuar qartë në mënyrë që të maten njëllë nga njerëz të ndryshëm. Kur themi "përqindja e grave me rritje akses në shërbimet bazë" në këtë rast termi akses nuk është i qartë, nuk është i përcaktuar saktë.

P.sh. shkalla e regjistrimit në shkolla matet me numrin e nxënësve të regjistruar në tetëvjeçare ndaj numrit total të popullsisë në grup-moshën që i përket atij niveli arsimor. Të dy variablat sasiorë që do të vihen në raport janë të përcaktuar qartë. P.sh. numri i nxënësve të regjistruar në tetëvjeçare, është qartësisht i përcaktuar, nuk ka dyshime. Nga ana tjetër numri total i fëmijve në grup-moshën specifike të tetëvjeçares (nga 6 në 15) është qartësisht i përcaktuar. Prandaj ka shumë rëndësi që të dhënat e mbledhura nga njerëz të ndryshëm në kohë të ndryshme për këta variabla të jenë të sakta, konsistente dhe të krahasueshme.

### Të saktë

Është e rëndësishme të zgjedhim tregues që masin në mënyrën më të saktë dhe korrekte fenomenin. P.sh. në matjen e kequshqyerjes së fëmijve nën 5 vjeç, treguesi i peshës ndaj gjatësisë jep një shifër më të saktë për këtë fenomen sesa të themi matja e perimetrit të pjesës së sipërme të krahut. Këtu duhet të kemi parasysh që matja ka të bëjë me kequshqyerjen akute të fëmijve nën 5 vjeç.



## Realistë

Treguesit e zgjedhur duhet të jenë realistë, të marrin parasysh mundësinë për të patur të dhëna me burimet ekzistuese. Disa tregues kanë kosto të lartë të mbledhjes së të dhënave ose ekspertizën që kërkojnë. P.sh. të tillë janë treguesit e keqshqyerjes që mund të llogariten mbi bazën e matjeve antropometrike, ose tregues të punësimit dhe papunësisë, që kërkojnë vrojtime me një kampion shumë të madh. Ky është një faktor shumë i rëndësishëm për t'u marrë parasysh dhe që çon në kompromis për të vendosur kritere të tjera.

## Me afate kohore

Treguesit duhet të kenë afate kohore, kryesisht në lidhje me kohën për mbledhjen e të dhënave. Treguesit duhet të reflektojnë kohën e mbledhjes së të dhënave. Mbledhja e të dhënave nuk mund të zgjatë pafundësisht. Nga ana tjetër, treguesit e ndikimit duhet të reflektojnë intervalin e kohës midis përfundimit dhe ndryshimeve të pritshme. Ky interval kohe është kuptimplotë veçanërisht për programe që synojnë reduktimin e varfërisë. Impakti i programeve për reduktimin e varfërisë nuk mund të jetë i menjëhershëm, kjo duhet të reflektohet në mbledhjen e të dhënave.

### 4.3 Shembuj të treguesve të monitorimit

Treguesit target janë objektiva sasiorë, të matshme, të monitorueshme që vendosen nga qeveritë në lidhje me zhvillimet ekonomike dhe sociale. Këto janë një instrument për të vlerësuar performancën e shteteve për të arritur synimet që ato kanë vendosur për një kohë të caktuar. Iniciativa OZHM, përmban 8 synime të mëdha, të cilat duhen arritur deri në vitin 2015.

**Target 1:** Përgjysmimi në periudhën 2002 deri më 2015 i përqindjes së popullsisë që jeton në varfëri ekstreme

**Objektivi 1:** Eliminimi i varfërisë ekstreme dhe urisë

Target 1: Përgjysmimi, ndërmjet 1990 dhe 2015, përqindjes së njerëzve që jetojnë me të ardhura më pas se 1 dollar (fuqi blerëse) në ditë

1. Proporcioni i popullsisë nën \$1 (PPP) në ditë
2. Indeksi i hendekut të varfërisë [incidenca x thellesinë]
3. Pjesa e kuintilës më të varfer në totalin e popullsisë.

Si i masim keta tregues?

Bazë të dhënash **à** të dhëna të përpunuara **à** ndërtim variablash **à** llogaritje indikatorësh **à** krahasim dhe monitorim politikash.

Për të matur dhe llogaritur treguesin e parë "përqindja e popullsisë nën linjën absolute të varfërisë" duhet të kalojmë në disa faza.

Faza e parë: hartimi i një pyetësori me një përmbajtje dhe strukturë që të sigurojë një informacion shumëplanesh për familjet dhe pjesëtarët e tyre;

Treguesit mijëvjeçarit dhe angazhimi për ulje

| Treguesit                                                                  | 2002   | 2006   | 2015  |
|----------------------------------------------------------------------------|--------|--------|-------|
| 1.1 - Përqindja e popullsisë nën linjën absolute të varfërisë              | 25.40% | 22%    | 13%   |
| 1.2 - Raporti i hendekut të varfërisë (incidenca x thellesinë e varfërisë) | 5.70%  | 5.00%  | 3.00% |
| 1.3 - Pjesa e kuintilës me të varfer në totalin e konsumit                 | 12.70% | 11.50% | 6.30% |

Faza e dytë: mbledhja e të dhënave, kontrolli cilësor i tyre, përpunimi;

Faza e tretë: llogaritja e një variabli agregat, që përfshin në vetvete të gjithë elementët e konsumit të një familje. Të dhënat e përpunuara nga anketimi janë baza për këtë. Janë të nevojshme të përdoren teknika statistikore të krijimit të variablave të tillë.

Faza e katërt: llogarisim një shportë produktesh ushqimore tipike për familjet e anketuara, i konvertojmë në kalori sipas metodave të rekomanduara për këtë qëllim, dhe më pas e kthejmë në vlerë leku duke vendosur çmimet përkatëse.

Faza e pestë: duke përdorur përkufizimet dhe formulat e llogaritjes, masim treguesin e varfërisë në përqindje. Kjo behet si më poshtë:

Koeficienti i varfërisë është ajo pjesë e popullsisë, konsumi i të cilës (ose matje të tjera të standartit të jetesës) është më i vogël se vlera e linjës së varfërisë.

$$H = \frac{q}{N}$$

H koeficienti i varfërisë

q të varfer

N popullsia gjithsej

Treguesi i hendekut të varfërisë është një tregues që mat sa të varfer në vlerën leku janë të varfërit. Hapat e mësipërme përgatitore na japin mundësinë që ne të vazhdojmë të llogarisim treguesit e tjere target, siç janë hendeku i varfërisë dhe treguesi i tretë, përqindja e konsumit të të varferve ndaj totalit të konsumit të popullsisë.

Në kuadrin e raportit të progresit të SKZHES dhe OZHM, u llogaritën treguesit e varfërisë. Të dhënat nga LSMS2002 u përdoren si bazë për llogaritjen e variablit të konsumit. Metodologjia e kostos së nevojave bazë (Ravallion dhe Bidani, 1994) ndihmoi për llogaritjen e linjës absolute të varfërisë, me 2288 kkal për frymë dhe në vlerën leku, 4891 lek për frymë në muaj. Kjo do të thotë që u vlerësua sipas rekomandimeve të FAO, që kuota minimum e kkalorive të marra për frymë duhet të jete 2288 kkal. Personat që në fakt konsumojnë më pak se kaq, konsiderohen të varfer.

Personat që konsumojnë më shumë se kaq, konsiderohen jo të varfer. Shporta ushqimore me vlerën e mësipërme të kalorive u konvertua në vlerë leku (4891 lek).

Duke zbatuar formulën e mësipërme, u llogarit numri i të varfërve që konsumonte më pak se 4891 lek në muaj dhe u llogarit koeficienti ose shkalla e varfërisë prej 25.4%.

#### 4.4 Disagregimi i treguesve

Disagregimi i treguesve ka rëndësi në procesin e monitorimit për efekte krahasimi midis grupeve dhe nëngrupeve. Disagregimi sipas gjinisë dhe grup-moshave është shumë i rëndësishëm në arritjen e Objektivave të Mijëvjeçarit që kanë në fokus barazinë gjinore si dhe arritjen e arsimimit të përgjithshëm.

Është e rëndësishme të theksojmë se aspekti gjinor merret parasysht në fazën e hartimit të instrumentave të mbledhjes së të dhënave. Kur hartohet një pyetësor duhet parashikuar që variabli gjini të jetë i pranishëm në modulën demografik të pyetësorit. Kjo bën të mundur që më pas, gjatë përpunimit të të dhënave, të ndërtohen tabela dhe tregues të ndarë në femra-meshkuj. Ky proces i kryer në fazën e analizës, quhet *disagregim*.

Disagregimi sipas njësive administrative në nivele të ndryshme është po aq i rëndësishëm nga pikëpamja e llogaritjes së treguesve rajonalë. Kur ndarja në nëngrupe bëhet në fazën e hartimit dhe hedhjes së shortit për një vërtetim me zgjedhje probabilitare, ky proces quhet *stratifikim*. Ndarja e kampionit që në fazën e zgjedhjes në strata sipas parametrevë dhe teknikave të caktuara. P.sh. gjatë hedhjes së shortit për LSMS kampioni u nda në 4 strata sipas faktorëve agro-klimatikë dhe ekonomikë e socialë, si dhe numrit të popullsisë për secilën nga këto strata. Ky proces ndihmon që në fazën e analizës, këto zona të shërbejnë si zona përgjithësuese të veçorive dhe treguesve social-ekonomikë që janë karakteristikë e tyre.

#### 5. Instrumenta të monitorimit të politikave: ndjekja e shpenzimeve publike

“Zakonisht njerëzit mendojnë (dhe shumë statisticienë tentojnë të mendojnë) se kur kemi të dhëna, kemi në dore përgjigjen ndaj pyetjeve që shtrën vendimarrja. Por kjo nuk është e vertetë, sepse vendimarrja nënkupton politikën dhe politika nënkupton polemikën. Kështu të njëjtat të dhëna që njëra palë mund t'i përdorë për të mbështetur politikën, tjetra palë i përdor për t'i kundërshtuar ato. Prandaj është shumë e vështirë të trajtohet pyetje politike, e megjithatë të dhënat ndihmojnë debatin”.

##### 5.1 Matja e treguesve për hartimin e politikave

Statistikat e shpenzimeve publike janë një instrument shumë i vlefshëm për të monitoruar politikën. Ndërtimi i treguesve të duhur bën të mundur që qeveria, vendimarrësit të dinë ku janë dhe ku do të shkojnë. Tregues të orientimit të politikave janë treguesit e varfërisë, që kanë një kontekst sa social dhe ekonomik. Analiza e burimeve të të ardhurave të të varfërve na tregon se sa programet

sociale të qeverisë shkojnë për të varfërit. Programi i ndihmës ekonomike, synon popullsinë e varfër, nën një minimum të caktuar jetik, por në fakt sa arrihet që kjo ndihmë të shkojë pikërisht tek familjet e synuara?

| Familja të varfëra | Familja jo varfëra |      |
|--------------------|--------------------|------|
| Me ndihme ek.      | 100%               | 0%   |
| Pa ndihme ek.      | 0%                 | 100% |

| Familja të varfëra | Familja jo varfëra |     |
|--------------------|--------------------|-----|
| Me ndihme ek.      | 25%                | 8%  |
| Pa ndihme ek.      | 75%                | 92% |

Burime të ndryshme të dhënash japin informacion të ndryshëm mbi mënyrën e shpërndarjes së ndihmës ekonomike në para. LSMS2002 sjell informacionin që tregon se tre të katërtat e atyre që marrin ndihmë është e varfër, por programi ka lënë jashtë tre të katërtat e familjeve të varfëra dhe dy të tretat e familjeve shumë të varfëra (Figura 2). Saktësia administrative mund të ndryshojë dhe përsa i përket shpërndarjes gjeografike dhe zonave të pushtetit lokal. Teorikisht shpërndarja e fondeve të ndihmës ekonomike duhet të paraqitet si në kuadratin e majtë në figuren 2. Kjo do të ishte shpërndarja ideale në kushtet kur e gjithë shumën e planifikuar të ketë shkuar vetëm dhe duke përfshirë të gjithë të varfërit.


Një nga instrumentat që do të ndihmonte në një buxhetim të fondeve publike sa më afër shtresave të prekura do të ishte matja e treguesve të varfërisë dhe pabarazisë për zona të vogla. Ka teknika të veçanta për llogaritje për këtë, autorët Elbers, Lanjouw and Lanjouw (2002,b) kanë zhvilluar metodologji që bazohen në të dhënat e regjistrimeve të popullsisë dhe vërtetimeve LSMS ose vërtetime të ngjashme pranë familjeve.

Hartat e detajuara në zona të vogla bëjnë të mundur që politikëbërësit të kenë në dore tregues për këto zona mbi të cilët mund të ndërtojnë politikën. Këto ndihmojnë në marrjen e vendimeve për të bërë rishpërndarjen e fondeve dhe buxheteve. Treguesit e pabarazisë dhe të varfërisë të diferencuar për komuna dhe bashki janë një informacion shumë i vlefshëm për të gjykuar më pas në hartimin e politikave sociale të tilla që të reduktojnë varfërinë dhe përmirësojnë nivelin e jetesës së familjeve

##### 5.2 Shpenzimet publike

Shumë e rëndësishme është të ndërtojmë tregues që të na informojnë mbi shpërndarjen e zërave të buxhetit, për të kuptuar se si dhe ku kanë shkuar paratë e këtij buxheti. Keta tregues ndërtohen për sektorë të ekonomisë duke pasqyruar kështu prioritetet e qeverisë.





Treguesit kryesore janë:

- shpenzime publike /GDP
- shpenzime publike për shëndetin (arsimin)/GDP
- shpenzime për shëndetin (arsimin)/ndaj shpenzimeve publike

Në tabelën e mësipërme vërehet se shpenzimet për shëndetin kanë ardhur në rënie nga 1991 në vitin 2002, nga 4.8% të GDP në 2.7% të GDP. Pra shpenzimet e buxhetit të shtetit për shëndetin në raport me Prodhimin e Brëndshëm Bruto, kanë ardhur në rënie ndërsa pjesa e këtyre shpenzimeve në raport me shpenzimet publike janë ulur në 2001 dhe më 2002 kanë ardhur në rritje.

makroekonomik dhe (vi) mbrojtja sociale të cilat janë gjithashtu edhe kushte për zbatimin e strategjisë.

## 6. Kartat e Raportimit të Qytetarëve (CRC)

### 6.1 Çfarë janë CRC

Përmendëm më sipër të dhënat, veçoritë, atributet, analizat dhe burimet e mbledhjes së tyre. Folëm gjithashtu për të dhënat cilësore, të cilat janë pjesë e vërtetimit sasiore dhe cilësore. Këto të fundit, shpesh janë një komplement i të dhënave sasiore, duke konfirmuar këto të fundit nëpërmjet vlerësimit që vetë qytetarët i bëjnë situatave, ngjarjeve, politikave.

Tabela 12: Shpenzimet Publike për Shëndetin

|                                                       | 1991 | 2000 | 2001 | 2002 |
|-------------------------------------------------------|------|------|------|------|
| Shpenzime publike gjithsej/GDP                        | 62.2 | 25.9 | 27.5 | 27.9 |
| shpenzime publike për shëndetin /GDP                  | 4.8* | 2.3  | 2    | 2.7  |
| shpenzime për shëndetin si % ndaj shpenzimeve publike |      | 8.8  | 7.4  | 9.8  |

Burimi: Ministria e Financave;

\* WHO/Europe, HFA Database, Qershor 2002

Në eksperiencën botërore, janë vërtetimet "Karta e Raportimit të Qytetarëve", që sigurojnë pikërisht një vlerësim, një matje të kënaqshmërisë së qytetarëve ndaj shërbimeve publike dhe agjencive të shërbimit publik (uji, korenti, shërbimet bashkiake, transporti, banimi, telefonat, bankat, spitalet).

Tabela 13: Shpenzimet Publike për Arsimin

|                                                     | 1991 | 2000 | 2001 | 2002 |
|-----------------------------------------------------|------|------|------|------|
| Shpenzime publike gjithsej/GDP                      | 62.2 | 25.9 | 27.5 | 27.9 |
| Shpenzime publike për arsimin në % të GDP           | 5    | 3.2  | 3.3  | 3.4  |
| shpenzime për arsimin si % ndaj shpenzimeve publike | 8.1  | 12.3 | 12   | 12.1 |

Burimi: Ministria e Financave

Qëllimi i anketimit me këtë modul ishte pikërisht matja e opinionit të popullsisë për shërbimet publike, krahas matjeve të njohura të të ardhurave, shpenzimeve, kushteve të banimit, tregut të punës, aksesit ndaj arsimit, shërbimeve shëndetsore, etj.

Këto vërtetimet janë pjesë e programit afatgjatë mbështetës të Bankës Botërore për të fuqizuar

Shpenzimet për arsimin janë ulur nga 1991, dhe rriten pas vitit 2000 në raport me GDP. Ndërsa në totalin e shpenzimeve publike vijnë në rritje pas 1999 me 4.2 pike përqindje dhe pas vitit 2000 vijnë në ulje, por jo të ndjeshme.

kapacitetet e monitorimit dhe vlerësimit për vendet në zhvillim. Me këtë synohet të monitorohen shërbimet publike dhe të rritet ndërgjegjësimi qytetar mbi rolin dhe të drejtat e tyre ndaj një shërbimi sa më të mirë nga ana e agjencive të shërbimeve publike.

Treguesit mbi shpenzimet publike janë një instrument në duart e qeverisë që të vendosë prioritetet në menaxhimin e shpenzimeve publike duke përfshirë burimet me nevojat. Prioritetet strategjike të qeverisë pasqyrohen në objektivat afatmesëm dhe në dokumentin strategjik të Planit Buxhetor Afatmesëm (MTEF). Në prioritetet e saj, realizimi i SKZHES, MAS, MDGs, NATO janë katër objektivat më kryesore dhe më të njohurat. Secila prej tyre ka nevojë për nivele të konsiderueshme burimesh për t'u zbatuar. Objektivat prioritare sipas Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik dhe Social janë të përmbledhura si më poshtë: (i) Përmirësimi i shërbimeve në shëndetësi dhe arsim; (ii) përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve bazë për popullsinë; (iii) reforma institucionale; (iv) rritja ekonomike; (v) stabiliteti

### 6.2 Qëllimi dhe fusha e studimit

Konteksti dhe qëllimi i këtij studimi është që të shërbejë si një instrument i vlefshëm për të ndërgjegjësuar punonjësit publikë për të qenë të përgjegjshëm. Informacioni i marrë nga qytetarët lidhur me nivelin e performancës së punonjësve të shërbimit publik

konsiderohet i vlefshëm. Ata dinë më shumë se kushdo sa përgjegjëse dhe të besueshme janë agjenci të ndryshme të shërbimeve publike dhe cilat janë kostot prapa këtyre shërbimeve. Ky informacion konsiderohet një input i vlefshëm për qeveritarët në hartimin e politikave dhe kryerjen e reformave.

Një anketim i tillë është kryer me sukses nga Qendra e Punëve Publike e Bangladorit, Indi në vitet 1994, 1999 dhe 2003. Nëpërmjet anketimeve pranë familjeve merret feedback nga qytetarët mbi cilësinë e shërbimeve të agjencive kryesore të shërbimeve publike. U përdorën gjithashtu edhe Karta të specializuara të Raportimit. Qëllimi i studimit është të studjojë në mënyrë të pavarur kontributin e Kartave të raportimit të Qytetarëve (CRC) në këto rezultate kryesore:

1. Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve;
2. Rritja e aktivizimit qytetar lidhur me shërbimet publike;
3. Rritja e ndërgjegjes publike të cilësisë së shërbimeve dhe fakti që qytetarët kanë të drejtën dhe fuqinë të kërkojnë shërbime më të mira;
4. Orientimi ndaj klientit në pjesën e agjensive të shërbimeve publike;
5. Përsëritja e Kartave të Raportit Qytetar në vënde të tjera.

Vlerësimi është bërë nga :

a) intervista individuale me një kampion shefish të agjencive dhe staf të nivelit të lartë të agjencive të mbuluara nga Kartat e Raportimit. Janë kryer 19 intervista. Ky kampion nuk ishte përfaqësues i agjencive. Kampioni u zgjodh në mënyrë të tillë që të përfshihen në të zyrtarë të agjensive të cilët ishin të

familjarizuar me CRC dhe rezultatet e tyre dhe kishin njohuri për përdorimin e tyre.

b) Intervista me disa zyrtarë të lartë të qeverisë. U intervistuan pesë zyrtarë që normalisht kishin njohuri mbi rezultatet e CRC dhe përdorimin e tyre.

Në anketën LSMS2002 si dhe në vërtetimet panel, i është kushtuar një modul i veçantë (figura 2) opinionit të familjarëve mbi vlerësimin që ata i bëjnë situatës së shërbimeve publike si arsimi, shëndetsia, furnizimi me ujë, energji elektrike, transporti, telefonat, shërbimet bashkiake, policore, etj. Një kampion prej rreth 1800 familjesh janë pyetur më 2003 dhe 2004. Ky instrument plotësohet me një pyetsor komuniteti me të cilin intervistohen zyrtarë të shërbimeve publike.

The screenshot shows a Microsoft Excel spreadsheet titled "ALLENMAN (VARS)\_V3\_Vignette". The spreadsheet contains a survey form with various sections for data entry. The form includes checkboxes and text boxes for data entry. The sections are as follows:

- SECTION 1: IDENTIFY THE RESPONDENT**
  - NAME OF THE RESPONDENT: [Text Box]
  - ADDRESS OF THE RESPONDENT: [Text Box]
- SECTION 2: IDENTIFY THE SERVICE PROVIDER**
  - NAME OF THE SERVICE PROVIDER: [Text Box]
  - ADDRESS OF THE SERVICE PROVIDER: [Text Box]
- SECTION 3: IDENTIFY THE SERVICE**
  - NAME OF THE SERVICE: [Text Box]
  - ADDRESS OF THE SERVICE: [Text Box]
- SECTION 4: IDENTIFY THE SERVICE PROVIDER**
  - NAME OF THE SERVICE PROVIDER: [Text Box]
  - ADDRESS OF THE SERVICE PROVIDER: [Text Box]
- SECTION 5: IDENTIFY THE SERVICE**
  - NAME OF THE SERVICE: [Text Box]
  - ADDRESS OF THE SERVICE: [Text Box]

Fjalë kyç: statistika, njohuri statistikore, variabla, attribute, frekuencat, mesatarja, moda, mediana, shpërndarja normale, paraqitja grafike, varianca, korelacioni, paraqitja tabelare, vrojtme me zgjedhje, statistika deskriptive, statistika të përgjithësimit, probabiliteti, treguesit, tregues hyrës, përfundim, rezultate, impakt, disagregim, stratifikim, harta të varfërisë, shpenzime publike, pyetësor, karta e raportimit të qytetarëve.

#### *Bibliografi:*

- q *Bohrnstedt and Knoke*, Statistics for Social Data Analysis, second Edition.
  
- q *Schiold M., Augsburg College*, Statistical Literacy and Evidential Statistics.
- q *Schiold M., Augsburg College*, Describing rates and Percentages in Tables.
- q *Holmes P.*, Nottingham Trent University Statistical Literacy, numeracy and the future.
- q *Schiold M., Augsburg College* Statistical Literacy: reading tables of rates and percentages .
- q GAO, Quantitative Data Analysis, an Introduction.
- q The statistics homepage.
- q *Schiold M., Augsburg College*, Correlation, Determination and causality in introductory statistics.
- q UNDP, Raporti i Zhvillimit Njerëzor për Shqipërinë, 2005.
- q Strategjia Kombetare e Zhvillimit Ekonomik dhe Social, Raporti i Progresit 2003.
- q *World Bank*, Albania Poverty Assessment 2003.
- q *INSTAT*, Hartat e varfërisë dhe pabarazisë, 2004.
- q UNDP, Social Indicators handbook, studies and methods.
- q IMF, Achieving the MDGs and related outcomes: a framework for monitoring policies and actions.
- q *World Bank*, An Assessment of the Impact of Bangalore Citizen Report Cards on the Performance of Public Agencies ECD Working Paper Series f& 12 .
- q *Audrey R. Chapman*, Ph.D. Indicators and Standards for Monitoring Economic, Social and Cultural Rights.
- q HDPC 2002, The Albanian response to the Millenium Development Goals.

## ANEKS 1

## KAPITULLI 1

Pyetje:

- Çfare kurba e Gausit?
- Sa dini per Kurben e Lorenzit
- Sa dini per Koeficientin Gini

## Kapitulli 2

Ushtrim 1. Në tabelën e mëposhtme jepen të dhëna për pesë pedagogë të Fakultetit të Ekonomisë.

| Emri | Specialisti  | Gjinia | Mosha | Grada ose titulli shkencor |
|------|--------------|--------|-------|----------------------------|
| A.H. | Ekonomiks    | M      | 40    | Profesor i asocuar         |
| B.Y. | Menaxhim     | M      | 55    | Profesor                   |
| C.T. | Marketing    | F      | 34    | Doktor                     |
| D.M. | Kontabilitet | F      | 26    | Asistent                   |
| E.K. | Financë      | M      | 42    | Profesor                   |

- Sa elementë përmban ky studim?
- Sa variabla janë?
- Sa vrojtime janë?
- Cila shkallë e matjes është përdorur për secilin variabël?

Ushtrim 2. Në tabelën e mëposhtme jepen të dhëna për 8 kompani të suksesshme në rrethin e Tiranës sipas vlerësimit të bërë nga një studjues:

| Emri           | Shitjet | Renditja sipas shitjes | Fitimi | Renditja sipas fitimit |
|----------------|---------|------------------------|--------|------------------------|
| AlbaA          | 121085  | 1                      | 4856   | 1                      |
| Imobiliari     | 92445   | 2                      | 5300   | 3                      |
| K.A.Co         | 79557   | 3                      | 5260   | 4                      |
| Albko          | 59681   | 4                      | 5806   | 2                      |
| Tir&Tir        | 49414   | 5                      | 3386   | 5                      |
| M&M            | 48198   | 6                      | 2087   | 6                      |
| AlbGas         | 35472   | 7                      | 1050   | 8                      |
| K.Distribution | 33544   | 8                      | 1304   | 7                      |

- a. Sa elementë janë në këtë paraqitje të të dhënave?  
b. Sa variabla janë?

c. Sa vjetër janë?  
d. Cila shkallë e matjes është përdorur për secilin variabël?

|                  | Moshë | 20-24 | 25-29 | 30-34 | 35-39 | 40 vjeç | Gjithsej |
|------------------|-------|-------|-------|-------|-------|---------|----------|
| Nr. i studentëve |       | 36    | 44    | 60    | 38    | 2       | 180      |

Ushtrim 3. Në tabelën e mëposhtme jepet shpërndarja e 180 studentëve të sistemit të korrespondencës sipas moshës.

- a. Sa % e studentëve të zgjedhur janë nën 25 vjeç?  
b. Sa % e studentëve të zgjedhur janë të paktën 35 vjeç?  
c. Bazuar në zgjedhje, sa % e studentëve të popullimit janë nën 30 vjeç?

### KAPITULLI 3

Ushtrim 4. Tre portokalle që një blerës ka blerë në supermarket peshojnë përkatësisht 80, 90 dhe 130 gram secila. Cili nga konkluzionet e mëposhtme është thjesht i nxjerrë nga statistika deskriptive dhe cili kërkon përgjithësime? Jepni shpjegime për secilin konkluzion.

- a. pesha mesatare e tre portokalleve është 100 gram  
b. pesha mesatare e portokalleve të shitura në këtë supermarket është 100 gram

### Ushtrim 5

Policia rrugore për të përcaktuar shpejtësinë mesatare të makinave në autostradë, matë shpejtësinë e 1 në çdo 10 makina që udhëtonin.

- a. A mendoni se kemi të bëjmë me popullim apo me zgjedhje?  
b. Cili është popullimi për këtë studim?  
c. Cila është zgjedhja?  
d. Çfarë shkallë matje është përdorur?

Ushtrim 6. Popullimi është a) i barabartë me zgjedhjen, b) zgjedhje nga një zgjedhje e rastit, c) tërësia e të gjithë njësive që i interesojnë studimit, d) asnjëra

Ushtrim 7. Pjesa e popullimit e zgjedhur si përfaqësues e saj është a) statistikë përshkuese, b) statistikë analitike, c) statistikë, d) zgjedhje.

Ushtrim 8. Në një zgjedhje të rastit të 200 njësive, 5 janë me difekt. Vlerësimi i % së njësive me difekt për popullim është a) 5%, b) 2.5%, c) 200, d) asnjëra

### KAPITULLI I KATËRT

#### Ushtrim 9:

Sa do të jete shkalla e varferise (H0) nese :

Numri i të personave qe jetojne nen linjen e varferisë është 350,000 njerëz  
Numri i përgjithshem i popullsisë është 3,115,000 njerëz

#### Ushtrim 10:

- a.  
Numri I femijve te rregjistruar ne klasen e 5te eshte 9600  
Numri I femijve gjithsej te moshes 11 vjecare eshte 9800  
Sa do te jete shkalla e rregjistrimit ne shkolle ne klasen e peste?

- b.  
Numri I femijve te rregjistruar ne klasen e 5te eshte 9000  
Numri I femijve gjithsej te moshes 11 vjecare eshte 8800

Sa do te jete shkalla e rregjistrimit ne shkolle ne klasen e peste?  
Cili eshte ndryshimi midis treguesit a dhe b?

### KAPITULLI 5

#### Ushtrim 11:

Nese themi qe kemi nje rritje te PBB me +4%, nje rritje të pabarazisë me +2% dhe nje rritje te shkalles se krimeve me 3%,:

- a. Kemi rritje ekonomike sepse eshte rritur PBB  
b. Kemi rritje ekonomike por rritja nuk ka ndikuar të të varfërit  
c. Rritja e PBB ka kosto sociale  
d. Rritja e krimeve vjen si rezultat I rritjes se pabarazise

#### Ushtrim 12

Një nga treguesit e target 1 të OZHM është: konsumi i pjesës me të varfër të popullsisë ndaj totalit të konsumit. Nëse do t'ju duhet të vendosni se si do të jetë ky tregues në 2015 ju do parashikoni:

- a. një tregues në ulje  
b. një tregues në rritje  
c. një vlerë të caktuar  
d. asnjëra nga me sipër